

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005, datë 10.5.2005, si dhe nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet t; mbajtur më datën 29 shkurt 2012, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN - "KUADRATET E 5.6;E 5.9; DHE NJË PJESË E KUADRATIT F 5.2" TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së "*Kuadratit E5.6; E 5.9; dhe një pjesë e Kuadratit F5.2*" të qytetit të Prizrenit, e cila është ofruar si donacion nga "Studio projektuese "CONTROL PRODUCTS, shpk nga Prishtina të cilën e përfaqëson Murat Kuqi, drejtor, (bartës i hartimit të planit), e që është hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit, i cili është hartuar konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr.2003/14, datë 3.7.2003.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban për "*Kuadratit E- 5.6; E- 5.9; dhe një pjesë e Kuadratit F- 5.2*" të qytetit të Prizrenit, përfshihen këto ngastra kadastrale: 6980/1,6981,7053/1,7053/2,7052,7056,7058,6978/1,7057,7059/1,7060/1,7062/1,7066/2,7066/1,7067,7069,11059,7070,10994,7083,7082/2,11059/1,7077/3,7082/1,7081,11059/2,7077,7095,7105,6081,7068,7065,7064,7063,7059/3.

Neni 3

Plani Rregullues Urban përfshinë lokacionin që kufizohet: në perëndim me rrugën "Tirana", në lindje me rrugën "Wesli Clark", përkatësisht me kuadratin E 5.1 E.5.7 E.5.8 F.5.1 dhe F.5.5, i cili PRRU do të inkurajojë strategjinë zhvillimore të Komunës së Prizrenit për periudhën 5- vjeçare.

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurta për investime.

Neni 5

Ky Vendim, bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, dhe 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit

Neni 6

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5- (pesë) vjeçare, ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011- 2341
Më 29 shkurt 2012
Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

